



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK dënon rëndë rastin e ngacmimit seksual të së miturës nga zyrtari komunal në Istog

Dje, sipas burimeve të Koha.net, u bë i njohur lajmi se një e mitur në Istog është ngacmuar seksualisht në komunë nga një zyrtar i kësaj komune, përderisa po aplikonte për bursë. Pasi që e dëmtuara e ka paraqitur rastin në Policinë e Republikës së Kosovës, thuhet se personit që e ka ngacmuar atë seksualisht, i është shqiptuar masa e paraburgimit prej 24 orëve.

Ndërsa, Kryetari i Komunës së Istogut, z. Haki Rugova nuk ka dashur që rasti të cilësohet si skandaloz duke thënë se problemi në fjalë mund të zgjidhet ([shkruan Koha.net](http://shkruan.Koha.net)).

RrGGK thekson se ky është një rast skandaloz dhe dënon rëndë qëndrimin e kryetarit Haki Rugova, pasi mbi të gjitha ky rast është edhe shkelje e [Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Neni 4, artikulli 1.3](#) "Ngacmimi konsiderohet diskriminim, kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fytes) mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji."

Andaj, RrGGK kërkon që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin masat e duhura dhe kryesit të kësaj vepre t'i shqiptohet dënimi i merituar.

PRIS